



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1103/7 Prot.

Tiranë, më 18.04 2023

V E N D I M

Nr. 31 datë 18.04 2023

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR POZICIONET E PUNËS,  
NË ADMINISTRATË.**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, gërma d); në Rregulloren e UST-së, neni 41 “Personeli Administrativ”, pika 1,2,3,4,5, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ, në Universitetin e Sporteve të Tiranës” në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 “Për disa shtesa në vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, në shkresën e Administratorit nr.1100 datë 13.04.2023 “Për miratimin e kriterëve për 1 (një) pozicion pune në strukturën e administratës”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.04.2023,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për hapjen e procedurave të konkursit për 1 (një) pozicion pune, në strukturën e administratës, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë vijon:

- 1 (një) Specialist/e në Sektorin e Shërbimeve Financiare, pranë Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

***Kriteret e përgjithshme*** të kualifikimit janë si më poshtë:

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës, shkenca ekonomike dega financë.
2. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit parë ose të dytë, mbështetur në VKM “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura “. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);

3. Të ketë përvojë të mëparshme pune;
4. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
5. Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
6. Të jetë i aftë për punë.

#### **Kriteret e veçanta**

1. Të ketë diplomë të nivelit “Bachelor” ose “Master Profesional” / DIND në shkenca ekonomike.
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit në përputhje me pozicionin e punës.
3. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter, sidomos programin e kontabilitetit.
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup

2.Ngarkohet për vazhdimin e procedurave të mëtejshme Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/prot.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek portali i transparencës universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

